



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

**Specialist i Auditimit të Brendshëm,
niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”.**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut IV, pika 15 e Vendimit nr. 143, datë 12/03/2014, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Korçë shpall procedurat e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- 1 (një) Specialist i auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Korçë - kategoria III-b.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave: 16.02.2015

**Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.*

Përshkrimi përgjithësues i punës për grupin e pozicionin si më sipër është:

Pjesëmarrës për hartimin dhe miratimin e politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm, për kryerjen e auditimit të brendshëm të të gjitha strukturave, programeve, veprimtarive dhe proceseve, si dhe të njësive shpenzuese të nivelit më të ulët brenda njësisë publike.

Jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për auditimin e brendshëm publik, si dhe kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ligji përkatës

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” (Arsimi i lartë)

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 06.01.2015.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 20.02.2015, Bashkia Korçë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit www.bashkiakorçe.gov.al, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Bashkia Korçë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e auditimit të brendshëm;
- Njohuritë mbi Ligjin 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
 - Njohuri mbi legjislacionin, standartet kombëtare dhe ndërkombëtare, manualet në fushën e auditimit.
 - Njohuri mbi procedurat administrative;
 - Njohuri mbi menaxhimin financiar;
 - Njohuri mbi menaxhimin e burimeve njerëzore

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Korçë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

a) Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” në shkencat ekonomike ose juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.

b) Të kenë deri në 5 vjet experience pune në fushën e auditimit apo në profesion.

c) Të jenë pajisur me çertifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);

dh) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen nëpërmjet shërbimit postar ose dorazi në Institucionin e Bashkisë Korçë

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë ose në institucion duhet të bëhet brenda datës 16.02.2015

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri mbi ligjin për auditin e brendshëm në sektorin publik;
- Njohuri mbi ligjin e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare;
- Njohuri për menaxhimin financiar;
- Njohuri mbi manualin e auditit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Korçë, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Korçë duke filluar nga data 20.02.2015.